Flash Zjarri në Krujë, Ministri Lamallari: Policia ka arrestuar autorin e zjarrvënies së qëllimshme

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 'Marrëveshje ose dorëzim të plotë' Donald Trump paralajmëron se bllokada detare ndaj Iranit do të vazhdojë
2 Infantino kërkon ndihmën e Trump, formohet aleanca që do të paralizonte FIFA-n! Mocion mosbesimi dhe turne paralelë
3 70 ditë protestë/ Thirrje nga sheshi pas tërheqjes së Kullurit: Ata që kanë hatërmbetje, ejani të flasim! Refuzojnë 'Besën' e Ramës
4 Trump njoftoi rifillimin e negociatave me Iranin, bie me 4% çmimi i naftës në Azi
5 Arbenita Ismajli ndan fotot me veshje arabe, shikoni si duket

Kronikë

# Kavajë/ I riu tenton të vrasë me kallash 38-vjeçarin pas një sherri, vihet në pranga (VIDEO)

*Një 31 vjeçar, Neldi Hallulli u arrestua në Kavajë pasi dyshohet se mori një kallashnikov për të vrarë 38-vjeçarin Indrit Rama, me të cilin ishte konfliktuar më herët.*

Kavajë/ I riu tenton të vrasë me kallash 38-vjeçarin pas një sherri, vihe
Report TV
Watch on

Redaksia
8 Gusht, 13:55 | **Përditesimi: 8 Gusht, 14:02**

Share Post

KAVAJË- Një 31 vjeçar, Neldi Hallulli u arrestua në Kavajë pasi dyshohet se mori një kallashnikov për të vrarë 38-vjeçarin Indrit Rama, me të cilin ishte konfliktuar më herët.

Policia ndërhyri pas informacionit për sherrin dhe e kapi Hallullin teksa mbante kallashnikovin me vete, duke parandaluar vrasjen. Arma dhe municioni u sekuestruan.

Ndërkohë, nën hetim në gjendje të lirë u vendos Indrit Rama. Ky i fundit akuzohet për "dëmtime të tjera me dashje" pasi qëlloi me grushte 31-vjeçarin.


LEXO EDHE:
**Vritet me armë zjarri 20-vjeçari në Korçë, shërbente te Forcat e Armatosura! Autor shoku i fëmijërisë, e ndoqi brenda një pallati! Shpallet në kërkim, 3 të shoqëruar (EMRI + FOTO)**

> *"Pas marrjes së informacionit në rrugë operative se në zonën e Spillesë, Rrogozhinë, po ndodhte një konflikt, shërbimet e Policisë u organizuan dhe ndërhynë menjëherë për parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit.*
>
> *Si rezultat i veprimeve të shpejta dhe të koordinuara të shërbimeve të Komisariatit të Policisë Kavajë dhe Postës së Policisë Rrogozhinë, u bë e mundur kapja në flagrancë e shtetasit N. H. Në momentin e ndërhyrjes së shërbimeve të Policisë, ky shtetas mbante një armë zjarri, "Kallashnikov".*
>
> *Nga veprimet e para hetimore dyshohet se shtetasi N. H. kishte pasur një konflikt me shtetasin I. R. dhe, në vijim të konfliktit, dyshohet se kishte qëllim ta vriste atë.*
>
> *Ndërhyrja e menjëhershme e shërbimeve të Policisë bëri të mundur parandalimin e një ngjarjeje të rëndë kriminale, duke shmangur përshkallëzimin e konfliktit dhe pasojat e rënda për jetën e 38-vjeçarit.*
>
> *Po në vijim të veprimeve u procedua penalisht dhe shtetasi I. R., për "Dëmtime të tjera me dashje", sepse ka goditur me grushte shtetasin N. H., duke i shkaktuar dëmtime të lehta trupore", njofton Policia e Durrësit.*

-------------------------------

**Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë**

SI.E./E.H/Shqiptarja.com

TAG: policia e durresit vrasje kavaje Durres Indrit Rama Neldi Hallulli

**Komente** Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 5 Gusht, 13:27
**GJKKO kërkon të kufizojë aksesin e mediave dhe të drejtave të gazetarëve gjatë seancave, a jeni dakord?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera


4 vite pas sulmit, sërish tritol te lokali i Noizyt, gjendet një sasi e vogël e pashpërthyer në derë (VIDEO)
8 Gusht, 14:57


Piku i sezonit sjell fluks! Mbi 8 mijë e 500 udhëtarë mbërrijnë në Portin e Durrësit dhe Vlorës! Mbi 25 mijë shqiptarë të Kosovës u futën nga Morina në 3 orë
8 Gusht, 11:57


Tentuan t'i fusin në Shqipëri të padeklaruara, sekuestrohen 2 ora 'Rolex' dhe 351 cigare puro në Portin e Durrësit
7 Gusht, 19:56


Në shtator hap dyert shkolla dhe kopshti i ri në Ishëm, Rama: Mjedise bashkëkohore për fëmijët dhe komunitetin
7 Gusht, 17:09


Policia ndërhyn në plazhin e Spillesë, hiqen 101 çadra dhe 202 shezlongë të vendosur pa leje, procedohen 2 persona (VIDEO)
7 Gusht, 13:36


Vijon beteja me flakët, 8 vatra zjarri aktive në vend, rrezikohen banesat në Çikallesh të Kavajës, 600 efektivë, 3 helikopterë dhe avioni 'Air Tractor' në aksion
7 Gusht, 13:25


Në 7 muajt e parë të këtij viti, rreth 350 mijë pasagjerë kanë udhëtuar përmes Portit të Durrësit! Vetëm gjatë korrikut, rreth 113 mijë persona (VIDEO)
7 Gusht, 13:08


Zjarr në kazanët e plehrave në Durrës, digjen 3 makina
7 Gusht, 11:45


Punonjësi 40-vjeçar vdes në kantierin e ndërtimit të 'Durrës Marina' të Alabbarit, dyshohet se pësoi arrest kardiak (VIDEO)
6 Gusht, 16:59


Kruja kujton Abaz Kupin në 134-vjetorin e lindjes, ceremoni pranë banesës së tij historike (VIDEO)
Julian Shota
6 Gusht, 16:02


I dënuar në Itali me rreth 11 vite burg për trafik droge dhe falsifikim dokumentash, arrestohet 40-vjeçari në Durrës! Pritet të ekstradohet drejt vendit fqinj (EMRI+VIDEO)
6 Gusht, 14:21


Durrës/ E përplasi makina, humb jetën këmbësori (VIDEO)
5 Gusht, 22:34







Lajmi i fundit

**Zjarri në Krujë, arrestohet autori! Lamallari: Do të përballet me pasojat ligjore! Janë evakuuar banorët në afërsi të vatrës**
8 Gusht, 21:31



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit

Zjarri në Krujë, arrestohet autori! Lamallari: Do të përballet me pasojat ligjore! Janë evakuuar banorët në afërsi të vatrës
8 Gusht, 21:31
GetButton